



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

**Komisioni Vlerësues i Ofertave** (i themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, 01.nr.016-15794, të dt.11.02.2021), duke u bazuar në nenin 8, paragrafi 1.2, nenin 15, paragrafët 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.10/03 Prill 2019"), nenit 13, nenit 14, nenit 19, nenit 20 dhe 21 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.06/20 datë 05.08.2020), me qëllim të zbatimit të Vendimit Paraprak të Kuvendit Komunal për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (15-99 vite) të pronave të paluajtshme të Komunës përmes procedurave të shprehjes së interesit (Vendimi nr.01.016-15791 i datës 11.02.2021), në takimin e mbajtur me datë 28.04.2021 , mori vendim për shpalljen e :

## NJOFTIM PUBLIK PËR SHPREHJEN E INTERESIT

**Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) pronën e paluajtshme të komunës**

Në bazë të Vendimit Paraprak të Kuvendit Komunal nr.01-016-15791 të datës 11.02.2021, Komisioni Komunal për Vlerësimin e Ofertave përmes këtij njoftimi publik i fton të gjithë të interesuarit : personat juridik që të shfrytëzojnë mundësinë e marrjes në shfrytëzim me afat kohor prej 99 vjet, pronat e paluajtshme të komunës , të përshkruara më poshtë :

### 1. Parcelat kadastrale për dhënie në shfrytëzim:

- 1.1. Parcela me numër kadastral: 3696-0 me sipërfaqe 93,055 m<sup>2</sup> të zonës kadastrale Ponesh.
- 1.2. Parcela me numër kadastral: 3697-0 me sipërfaqe 1,990 m<sup>2</sup> të zonës kadastrale Ponesh.

1.3. Parcela me numër kadastral: 3698-0 me sipërfaqe 20,091 m<sup>2</sup> të zonës kadastrale Ponesh.

1.4. Parcela me numër kadastral: 4693-0 me sipërfaqe 41,526 m<sup>2</sup> të zonës kadastrale Ponesh.

**VËREJTJE:** Për shkak të formës gjeometrike të parcelave, konfiguracionit të terrenit dhe sipërfaqes funksionale të shfrytëzueshme të këtyre parcelave, parcelat trajtohen si një tërësi (si pako) dhe jo ndaras veç e veç në mënyrë që nga tërësia e tyre të përfitohet sipërfaqja funksionale për shfrytëzimin adekuat.

Pronat e përshkruara në pikën 1, gjenden afër rrugës Magjistrale Gjilan - Prishtinë (në anën e majtë të rrugës) në Zonën Kadastrale Ponesh, në drejtim të fshatit Bresalc dhe janë të përshtatshme për zhvillimin e afarizmit në lëmi të ndryshme ekonomike.

## 2. Kriteret për zgjedhjen e ofertave:

- 2.1. Vlera e investimeve (vlerësohet nga 1-10 pikë);
- 2.2. Numri i të punësuarve (vlerësohet nga 1-10 pikë);
- 2.3. Lloji i investimit i cili është me interes publik dhe me prioritet për komunën (vlerësohet nga 1-10 pikë);
- 2.4. Çmimi fillestar i qirasë vjetore për shfrytëzimin e tokës komunale: 200 €/ha;
  - Ofertimi mund të bëhet për totalin e sipërfaqes së të gjitha parcelave dhe do të vlerësohet me 10 pikë,
  - Ofertimi mund të bëhet për  $\frac{3}{4}$  e totalit e të gjitha parcelave dhe do të vlerësohet me 7 pikë,
  - Ofertimi mund të bëhet për  $\frac{1}{2}$  e totalit e të gjitha parcelave dhe do të vlerësohet me 5 pikë,
  - Ofertimi mund të bëhet për  $\frac{1}{4}$  e totalit e të gjitha parcelave dhe do të vlerësohet me 3 pikë.

## Kushtet e përgjithshme të ankandit publik :

1. Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës do të jetë afatgjatë për periudhe kohore 99 vjet.
2. Të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë personat juridik, bizneset e regjistruara në ARBK. Bizneset të cilët marrin pjesë, duhet ofertës bashkangjitur:
  - Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit me informata mbi biznesin;
  - Planin e biznesit;
  - Planin dinamik të investimeve;
  - Projektin ideor;
  - Vërtetimin e Tatimit në Pronë për pronat e paluajtshme që janë në pronësi të biznesit;
  - Vërtetimin nga ATK-ja mbi obligimet e kryera;
  - Fotokopjen e dokumentit valid të identifikimit - letërnjoftimin.

Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronave për shfrytëzim afatgjatë përmes shprehjes së interesit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në web-faqen e Komunës, në vendet publike dhe në media lokale, elektronike dhe të shkruara. Ofertat dorëzohen të mbyllura (në pliko), nëpërmjet Qendrës për Shërbim me Qytetar, (rr. "Bulevardi i Pavarsisë" nd. Soliteri, kati përdhesë), deri me datën 17.05.2021 në ora 15:00 h .

**Në anën e jashtme të plikos duhet shënuar të dhënat e aplikuesit si dhe Për: "Komuna e Gjilanit, Shprehja e interesit - Pronat në ZK Ponesh"**

**3. Vendi dhe koha ku do të mbahet ankandi publik:**

Ankandi publik do të mbahet në sallën e Kuvendit Komunal, (Objekti i ish Gjykatës Komunale, kati përdhesë), me datën 20.05.2021, në fillim në ora 10:00 ku do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik sipas masave dhe rekomandimeve të IKSHPK-së.

4. Pronat të cilat janë objekt i këtij njoftimi publik nuk mund të përdoren për qëllime tjera përpos siç është përcaktuar me ankand publik. Të njëjtat nuk mund të barten në personin e tretë ose të epen nën qira. Nga koha e nënshkrimit të kontratës mbi qiranë, shfrytëzuesi i fiton të gjitha të drejtat mbi shfrytëzimin e qetë të asaj prone por gjithashtu obligohet për pagesën e të gjitha taksave komunale dhe pagesave tjera të cilat burojnë nga marrëdhënia kontraktuese mbi qiranë.

5. Pjesëmarrësve në konkurrim i'u garantohet e drejta që të: informohen lidhur me procedurat e shprehjes së interesit; vizitojnë (shohin) pronat që do të jepen në shfrytëzim me dt. 12.05.2021 me fillim: nga ora 10:00-12:00 h.

6. Pjesëmarrësit në konkurrim kanë të drejtën e qasjes në dokumentacionet e pronës. Pjesëmarrësit në konkurrim kanë të drejtë të tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tri (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik. Në rast se fituesi i ankandit tërhiqet para nënshkrimit të kontratës, ankandi do të anulohet dhe do të rishpallet. Fituesi duhet të nënshkruaj regjistrin e procedurës së ankandit publik. Nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmojnë si të pasakta, komisioni ka të drejtën që të shpallë aplikacionin të pa vlefshëm dhe ta përjashton nga procedura e ankandit.

**7. Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës;**

7.1. Komisioni vlerësues brenda tri (3) ditë pune pas mbylljes së Njoftimit Publik bënë hapjen dhe vlerësimin e ofertave në vendin dhe kohën e përcaktuar më lartë. Pas vlerësimit të ofertave Komisioni Vlerësues harton raportin përfundimtar dhe përzgjedh ofertën më të favorshme.

7.2. Njoftimi për ofertën e përzgjedhur i dërgohet fituesit dhe vendoset në tabelën e shpalljeve publike dhe në web faqen zyrtare të komunës. Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në komisionin e ankesave brenda afatit prej 7 ditë;

- 7.2.1. Komisioni i ankesave shqyrton ankesat brenda dhjetë (10) ditësh dhe nëse konstaton se ka pasur shkelje gjatë procesit të vlerësimit kërkon rishqyrtimin e ofertave.
- 7.2.2. Nëse komisioni i ankesave vlerëson ankesat si të pabazuara, raporti i vlerësimit së bashku me ofertën e përzgjedhur i dërgohet Kuvendit të Komunës për miratim së bashku me këto dokumente: Një kopje të shpalljes së njoftimit për shprehje të interesit; procesverbalin e hapjes së ofertave dhe raportin për vlerësimin e ofertave; rekomandimin e komisionit për përzgjedhjen e fituesit; një kopje të protokolluar të ofertës së përzgjedhur dhe ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në shprehjen e interesit.
- 7.2.3. Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit të raportit të komisionit dhe ofertës së rekomanduar miraton me shumicën e votave të anëtarëve prezent dhe që votojnë vendimin përfundimtar për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë. Nëse kuvendi miraton vendimin përfundimtar atëherë autorizon kryetarin e komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit të lidhë kontratën me fituesin.
- 7.2.4. Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës nënshkruhet nga kryetari i komunës i cili e përfaqëson komunën dhe nga fituesi i përzgjedhur me anë të së cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

**Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve për konkurrim në ankand publik mund të bëhet në formë fizike në Qendrën për Shërbim me Qytetar në Gjilan ose në formë elektronike në Ueb faqen e Komunës së Gjilanit.**

Gjilan, 28.04.2021



**Komisioni Vlerësues i Ofertave**

*Bekim Bajrami*  
/ **Bekim Bajrami, Kryesues/**